



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 maj 2015  
Nr. ref.: RK790/15

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

në

**Rastin nr. KI160/14**

Parashtrues

**Ejup Jakupi**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,  
Rev. 215/2014, të 1 shtatorit 2014**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar,  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z. Ejup Jakupi, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 tetor 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 215/2014, të 1 shtatorit 2014. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, duke refuzuar revizionin si të palejuar, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi nuk ka specifikuar asnjë dispozite konkrete të Kushtetutës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 27 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 nëntor 2014, Kryetari, me Vendimin GJR. KI160/14 caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin KSH. KI160/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 18 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në Gjykatën Supreme.
8. Më 25 nëntor 2014, parashtruesi dorëzoi, me iniciativën e tij, dokumente shtesë në Gjykatë.
9. Më 15 prill 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

10. Parashtruesi i kërkesës ka punuar si regjistruer i pronës në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në Komunën e Gjilanit, prej 20 gushtit 2002 deri më 1 qershor 2011, kur është pensionuar.
11. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Gjilan, duke kërkuar që Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim në

Komunën e Gjilanit t'i paguajë një shumë të caktuar, në emër të pagës jubilarë, me rastin e pensionimit të tij.

12. Më 9 shtator 2013, Gjykata Themelore në Gjilan nxori Aktgjykimin C. nr. 794/2012, duke aprovuar pjesërisht padinë e parashtruesit përkitazi me kërkesën e shpërblimit jubilar në një shumë të caktuar të hollash, me kamatë vjetore 3.5%, ndërsa refuzoi kërkesën e parashtruesit, që pala e paditur t'i paguajë një shumë tjetër të caktuar të hollash, në emër të regresit.
13. Më 30 shtator 2013, Komuna e Gjilanit ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit C. nr. 794/2012 të Gjykatës Themelore në Gjilan për shkak të “ 1. Shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; 2. Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe 3. Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”.
14. Më 8 prill 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin AC. nr. 3310/13, me të cilin pranoi ankesën e Komunës së Gjilanit. Gjykata e Apelit vendosi që të marrëveshja kolektive, në të cilën Parashtruesi bazonte kërkesën e tij për pagë jubilarë, ishte lidhur në vitin 2005 dhe ishte në fuqi për 3 (tre) vite, gjegjësisht skadoi në vitin 2008. Prandaj Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u anulua.
15. Më 20 maj 2013, parashtruesi dorëzoi një kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit AC. nr. 3310/13 të Gjykatës së Apelit. Sipas parashtruesit, Gjykata e Apelit me rastin e marrjes së Aktgjykimit AC. nr. 3310/13 kishte bërë “shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf. 2, shkronja n etj. të LPK-së dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale”.
16. Më 1 shtator 2014, Aktvendimi i Gjykatës Supreme (Rev. 215/2014) hodhi si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, sepse vlera e kontestit ishte nën limitin ligjor në bazë të të cilin mund të shqyrtohen kërkesat për revizion.
17. Në pjesën e arsyetimit të aktvendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi:

*“ Nga shkresat e lëndës rezulton se vlera e këtij kontesti në padinë e paditësit, të paraqitur me datën 06.10.2011, është caktuar në shumën prej 1.664,25 €, dhe se më vonë nga ana e palës paditëse nuk është ndryshuar kjo vlerë e kontestit.*

*Në këtë gjendje të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e paraqitjes së këtij revizioni, gjeti se i njëjti është i palejuar. Sipas nenit 211.2 të LPK, revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadija ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit të cilën paditësi e ka përcaktuar në padi, nuk kalon shumën prej 3000 €”.*

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin Rev. 215/2014, të 1 shtatorit 2014, duke ia hedhur poshtë si të palejueshëm revizionin, Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, por pa specifikuar dispozitat përkatëse kushtetuese.
19. Në shkresën e tij të dorëzuar më 25 nëntor 2014, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta *“nuk kanë punuar në mënyrë të drejt ligjore, por kanë punuar në mënyrë jo të drejt, por kanë punuar me njoftësi familjare, shoqërore, miqësore etj”*.

## **Vlerësimi i pranueshmerisë së kërkesës**

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që të parashtojë kërkesë në Gjykatë, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar (...)”*.

22. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d), 36 (2) b) dhe d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*[...]*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;*

*[...], ose*

*d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.

23. Parashtruesi pretendon se Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. 215/2014, i 1 shtatorit 2014, i ka shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutë, pa specifikuar ndonjë dispozitë konkrete të Kushtetutës, por duke aluduar në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.
24. Në lidhje me këtë, parashtruesi fare nuk ka shpjeguar si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

25. Gjykata Kushtetuese ripërsërit se sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
27. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
28. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi, nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie*, që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Shih, rastin Nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013, dhe të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).
29. Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave kushtetuese, dhe parashtruesi nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme, si dhe pse Aktvendimi i Gjykatës Supreme i kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d), 36 (2) b) dhe 36 (2) d) të Rregullores së punës, më 7 maj 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Kadri Kryeziu

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



  
Prof. dr. Enver Hasani